



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/112

Datë: 18.10.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 18 tetor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Inspektoratin Shëndetësor.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/112

Datë: 18.10.2016


Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 dhe të nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke iu referuar kërkesës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me nr. protokoll. 607/6-2015 datë 09.09.2016, në mbledhjen e mbajtur më 18 tetor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohen shpronësimet shtesë të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat janë të nevojshme për realizimin e Projektit me interes publik - ndërtimi i Rrugës Nacionale N2 Prishtinë-Mitrovicë, Segmenti Milloshevë-Vushtrri, Zona Kadastrale Milloshevë, Komuna Obiliq, sipas tabelës e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat e bashkëngjitura këtij vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelës me nr. protokoll. 6156/15 datë 10.12.2015, në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" me nr. protokoll. 5097/15 datë 09.10.2015, bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkuar dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara sipas pikës 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bën shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkuar, cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit/MMPH do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyrat kadastrale janë të obliguara të kryejnë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/112


Datë: 18.10.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 18 tetor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Rregullimin e Fushës së Metrologjisë.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/112

Datë: 18.10.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke iu referuar kërkesës së Ministrisë së Financave, me numër protokolli 3091 datë 13.10.2016, në mbledhjen e mbajtur më 18 tetor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 30,000 euro (tridhjetë mijë euro), për mbulimin e shpenzimeve të sigurisë dhe nevojave tjera emergjente të NPQ "Aeroporti i Gjakovës" SH.A.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria ekonomike e Rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik kod organizativ 213, nën-programi Njësia për Politika dhe Monitorimin e NP, me kod 23300, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/112

Datë: 18.10.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 18 tetor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes Bilaterale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut.
2. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian që të ndërmarr të gjitha hapat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të Marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/112
Datë: 18.10.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 18 tetor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut për zbatimin e Marrëveshjes Bilaterale për Bashkëpunim Zhvillimor.
2. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian që të ndërmarr të gjitha hapat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të Memorandumit.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/112
Datë: 18.10.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 14 të Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 18 tetor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Financave për kursime në kategorinë ekonomike të pagave dhe mëditjeve në shumë prej €2,213,407, për vitin 2016, si vijon:

1. Kuvendi (101), nga ndarjet buxhetore kursen €295,000 si në vijim:

- 1.1. €227,000 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Anëtarët e Kuvendit (10100), kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje.
- 1.2. €53,000 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Administrata e Kuvendit (10200), kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje.
- 1.3. €15,000 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Stafi Mbështetës Politik (15800), kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje.

2. Ministria e Financave (201), nga ndarjet buxhetore kursen €15,000

- 2.1 €15,000 reduktim i ndarjes buxhetore në nën programin Departamenti i Partneritetit Publiko Privat (21810), kategoria ekonomike paga dhe mëditje.

3. Organi Shqyrtues i Prokurimit (240), nga ndarjet buxhetore kursen €14,000

- 3.1 €14,000 reduktim i ndarjes buxhetore në nën programin Departamenti i Partneritetit Publiko Privat (15900), kategoria ekonomike paga dhe mëditje.

4. Agjencioni Shtetëror për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (251), nga ndarjet buxhetore kursen €29,600

4.1 €29,600 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Agjencioni Shtetëror për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (26100), kategoria ekonomike paga dhe mëditje.

5. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (328) nga ndarjet buxhetore kursen €700,000

5.1. €700,000 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (33300), kategoria ekonomike paga dhe mëditje.

6. Agjencia Kosovare e Pronave (329) nga ndarjet buxhetore kursen €184,302

6.1. €184,302 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Agjencia Kosovare e Pronave (60600), kategoria ekonomike paga dhe mëditje.

7. Zyra e Rregullatorit për Energji (238) nga ndarjet buxhetore kursen €22,694

7.1. €22,694 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Zyra e Rregullatorit për Energji (42500), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,

8. Institucioni i Avokatit të Popullit (321) nga ndarjet buxhetore kursen €250,000

8.1. €250,000 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Institucioni i Avokatit të Popullit (32400), kategoria ekonomike paga dhe mëditje.

9. Gjykata Kushtetuese e Kosovës (243) nga ndarjet buxhetore kursen €25,000

9.1. €25,000 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Gjykata Kushtetuese e Kosovës (23800), kategoria ekonomike paga dhe mëditje.

10. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (208) nga ndarjet buxhetore kursen €18,741

10.1. €18,741 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Instituti i Lepasaviqit (97200), kategoria ekonomike paga dhe mëditje.

11. Ministria e Shëndetësisë (206) nga ndarjet buxhetore kursen €405,000

11.1. €15,000 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Zhvillimi i Resurseve Njerëzore në KPSH (71000), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,

11.2. €30,000 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Sistemi i Informimit Shëndetësor (72100), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,

11.3. €280,000 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Shërbimi Shëndetësor i Burgjeve (72600), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,

11.4. €80,000 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Shërbimi Mbështetës Administrativ (719), kategoria ekonomike paga dhe mëditje.

12. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (244) nga ndarjet buxhetore kursen €18,000

12.1. €18,000 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (25000), kategoria ekonomike paga dhe mëditje.

13. Instituti Gjqësor i Kosovës (322) nga ndarjet buxhetore kursen €15,000

13.1. €15,000 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Instituti Gjqësor i Kosovës (91600), kategoria ekonomike paga dhe mëditje.

14. Këshilli Prokurorial i Kosovës (250) nga ndarjet buxhetore kursen €221,070

14.1. €221,070 reduktim i ndarjes buxhetore në nën-programin Prokuroria Speciale (32200), kategoria ekonomike paga dhe mëditje.

II. Mjetet nga pika I. e këtij vendimi në shumë prej 2,213,407, ndahen për organizatat buxhetore si në vijim:

1. Zyra e Kryeministrit (104), ndahen mjete buxhetore €16,910

1.1. €16,910 ndahen mjete buxhetore për nën programin Agjencia e Statistikave të Kosovës (12400), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,

2. Ministria e Financave (201), ndahen mjete buxhetore €15,000

2.1. €6,500 ndahen mjete buxhetore për nën programin Zyra e Ministrit (11401), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,

2.2. €8,500 ndahen mjete buxhetore për nën programin Dogana (13300), kategoria ekonomike paga dhe mëditje.

3. Ministria e Diasporës (219), ndahen mjete buxhetore €19,815

3.1. €19,815 ndahen mjete buxhetore për nën programin Zyra e Ministrit (11419), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,

4. Agjencioni për Shërbimet e Navigimit Ajror (254), ndahen mjete buxhetore €200,000

4.1. €200,000 ndahen mjete buxhetore për nën programin Agjencioni për Shërbimet e Navigimit Ajror (37600), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,

5. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (203), ndahen mjete buxhetore €137,341

5.1. €37,827 ndahen mjete buxhetore për nën programin Zyra e Ministrit (11403), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,

5.2. €10,436 ndahen mjete buxhetore për nën programin Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve (40100), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,

5.3. €45,000 ndahen mjete buxhetore për nën programin Agjencia e Pyjeve të Kosovës (40300), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,

5.4. €4,730 ndahen mjete buxhetore për nën programin Departamenti i Shërbimeve Këshillimore Teknike (40400), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,

- 5.5. €15,375 ndahen mjete buxhetore për nën programin Instituti Bujqësor i Kosovës (40500), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,
 - 5.6. €1,225 ndahen mjete buxhetore për nën programin Departamenti i Pylltarisë (40600), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,
 - 5.7. €79 ndahen mjete buxhetore për nën programin Departamenti i Politikave dhe Zhvillimit Rural (40700), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,
 - 5.8. €289 ndahen mjete buxhetore për nën programin Departamenti i Verërave të Kosovës (45800), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,
 - 5.9. €5,072 ndahen mjete buxhetore për nën programin Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore (47300), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,
 - 5.10. €17,308 ndahen mjete buxhetore për nën programin Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë (47400), kategoria ekonomike paga dhe mëditje.
- 6. Ministria e Punëve të Jashtme, (216), ndahen mjete buxhetore €435,706**
- 6.1. €435,706 ndahen mjete buxhetore për nën programin Ambasadat (14300), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,
- 7. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (208), ndahen mjete buxhetore €1,171,936**
- 7.1. €153,539 ndahen mjete buxhetore për nën programin Universiteti i Ferizajit (98400), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,
 - 7.2. €275,884 ndahen mjete buxhetore për nën programi Agjencia e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (97500), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,
 - 7.3. €194,398 ndahen mjete buxhetore për nën programin Universiteti i Gjakovës (97800), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,
 - 7.4. €180,000 ndahen mjete buxhetore për nën programin Universiteti i Pejës (97400), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,
 - 7.5. €56,000 ndahen mjete buxhetore për nën programin Qendrën e Studenteve (90500), kategoria ekonomike paga dhe mëditje,
 - 7.6. €312,115 ndahen mjete buxhetore për nën programin Universiteti i Mitrovicës (97900), kategoria ekonomike paga dhe mëditje.
- 8. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (302) ndahen mjete buxhetore €30,000**
- 8.1. €30,000 ndahen mjete buxhetore për nën-programin Departamenti i Auditorëve (13400), kategoria ekonomike paga dhe mëditje.
- 9. Zyra e Presidentit (102) ndahen mjete buxhetore €96,099**
- 9.1. €96,099 ndahen mjete buxhetore për nën-programin Zyra e Presidentit (10500), kategoria ekonomike paga dhe mëditje.

10. Agjencioni Kosovar i Inteligjencës (245) ndahen mjete buxhetore €40,000

10.1. €40,000 ndahen mjete buxhetore për nën-programin Agjencioni Kosovar i Inteligjencës (25500), kategoria ekonomike paga dhe mëditje.

11. Agjencioni Kosovar i Privatizimit (239), ndahen mjete buxhetore €50,600

11.1. €50,600€ ndahen mjete buxhetore për nën programin Administrata Qendrore me kod 22900, kategoria ekonomike paga dhe mëditje.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë